

Me  
Dana

05 - 04 - 2018

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues, Elmaz Zenuni, me Zyrtarin ligjor Gazmend Bytyqi në çështjen penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR] nga Ferizaji , Rruga” [REDAKTUAR] pa nr., për shkak të veprave penale : 1. “Organizimi i skemave piramidale dhe bigjazit të pa ligjshëm” nga neni 300 par.2 të KPRK-së dhe 2. ”heqja apo dëmtimi i vulave ose i shenjave” nga neni 414 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-së në Ferizaj PP/II nr1855-5/16 të dt.20.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 07.03.2018. në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Valdet Avdiu, të pandehurit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

I akuzuari, [REDAKTUAR] nga Ferizaji , Rruga” [REDAKTUAR] pa nr., i lindur me [REDAKTUAR] në fshatin [REDAKTUAR] Komuna e Vitisë, nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e vajzërisë [REDAKTUAR] me profesion kamarier dhe menagjer në lokalit -Kazino-Bastore në Rrugën “ [REDAKTUAR] ” në Ferizaj, i martuar baba i 1(një) fëmie, ka të kryer shkollen e mesme , i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri, **ka qenë në arrest shtëpiak prej datës 17.10.2016 deri më 31.10.2016.**

## Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

1. me datën 14.10.2016, në Rrugën “Ismet Ramadani” në Ferizaj, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër ka organizuar lojrat e fatit pa poseduar leje përkatëse-licencë për një veprimtari të tillë, në atë mënyrë që ka instaluar lojërat e ashtuquajtura “ [REDAKTUAR] ” lojë kjo e ndaluar me ligj gjë që me rastin e një operacioni kontrolli nga ana e zyrtarëve të policisë së bashku me inspektorët e ATK-së, doganës dhe

Me këtë ka kryer veprën penale “Organizimi i skemave piramidale dhe bigjazit të pa ligjshëm” nga neni 300 par.2 të KPRK-së.

2. në periudhën kohore 14.10.2016 deri më 17.10.2016 në Rrugën “Ismet Ramadani” në Ferizaj, në loklain –objektin ” [REDAKTUAR] ” në Ferizaj, të cilin e ka menaxhuar i pandehuri ka dëmtuar shenjën zyrtare vulën ku shiritin e vendosuar nga ana e policisë dhe Administratës Tatimore të Kosovës me qëllim të sigurimit të atij lokali, ashtu që ka hapur objektin e e siguruar dhe ka vazhduar veprimtarinë në mënyrë të kundërligjshme,-

**Me këte ka kryer vepren penale ”heqja apo dëmtimi i vulave ose i shenjave” nga neni 414 të KPRK-së**

Andaj, Gjykata, në kuptim të nenit 300 par.2 dhe nenit 414 të KPRK-së, dhe neneve 4,7, 8 par.1, 9,10 par.1,17 par.1, 21 par.1 dhe 2, 41, 42 par.1 nënpar.1.1, 43 par.1 nënpar.1.3, 45, 46, 47, 73, 74, të KPRK-së, si dhe nenit 365, 366 , 450 dhe 463 të KPPRK-së, të pandehurin e :

## G J Y K O N

**I. Për pikën 1. Të dispozitivit të aktgjykimit ME DENIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj i cili konform nenit 47 të KPRK-së, Konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të dënuarit denimi me burg i zëvendësohet në denim me gjobë në shumën prej 1.500 euro /me shkronja: njëmijë e pesqind euro/, të cilën gjobë duhet ta paguaj brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse nuk paguhet gjoba i pandehuri e vuan denimin e shqiptuar me burg.**

**II. Për pikën 2. Të dispozitivit të aktgjykimit i shqiptohet DENIM ME GJOBË në shumën prej 300 eurove(me shkronja: treqind euro) të cilën gjobë duhet ta paguaj brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.**

Nëse dënimi me gjobë nën II.pika 2. të dispozitivit të këtij aktgjykimi nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 par. 3 të KPRK-së, në të kundërtën do ti zëvendësohet në denim burgimi, ashtu që për çdo 20 € i pandehuri do të vuaj 1 (një) ditë burgu.

E dëmtuara ATK për realizimin , për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në Kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguan shumën prej 20 € në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzë PP/II nr1855-5/16 të dt.20.11.2017, e ka ngarkuar të pandehurit, [REDAKTUAR] nga Ferizaji , Rruga” [REDAKTUAR] [REDAKTUAR]” pa nr., për shkak të veprave penale : 1. “Organizimi i skemave piramidale dhe bigjosit të pa ligjshëm” nga neni 300 par.2 të KPRK-së dhe 2. ”heqja apo dëmtimi i vulave ose i shenjave” nga neni 414 të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës së PTH-së,me datën 07.03.2017, mbajti shqyrtimin fillestar ku prezentuan prokurori i shtetit Valdet Avdiu, i pandehuri, kurëse i dëmtuari në cilësinë e të dëmtuarëve nuk ishin ftuar nga ana e gjykatës, pasi konform nenit 245 par.7 të KPPRK-së, në shqyrtim fillestar nuk kërkohet prezenca e tyre. Prokurori i shtetit për pikën 2 të dispozitivit të akuzës e ka korrigjuar vitin, ku në vend të vitit 2017 duhet të jet viti 2016,pjesa tjetër e pa ndryshuar.

Konform nenit 246 të KPPRK-së të pandehurit pasi që i janë dhënë udhëzimet nga ana e gjyqtarit gjatë shqyrtimit fillestar përkitazi me pranimin e fajsisë, i akuzuari e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës për veprat penale që e ngarkon prokurori i shtetit.

Në vlerësimin e pranimit të fajësisë së të pandehurit gjyqtari gjykues konform nenit 248 par.2 të KPPRK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit përkitazi me pranimin e fajsisë nga

ana e të akuzuarit, ashtu që prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit të cilët kanë deklaruar se mundë të shkohet me shqiptimin e dënimit.

Gjyqtari gjykues ka vlerësuar se kërkesat nga neni 248 paragrafi 1 i KPPRK-së janë përmbushur, pasi që:

- I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajsisë,
- Pranimi është bërë vullnetarisht. Pranimi mbështetet në prova dhe fakte të çështjes penale që përmban aktakuza dhe materialet e prezentuara nga ana e prokurorit të shtetit me aktakuzë dhe atë: Raporti fillestar i policisë dt.14.10.2016 dhe 17.10.2017, si dhe fotografitë të cilat gjinden në shkresat e lëndës.
- akuzat nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike, ndashtu i akuzuari është udhëzuar nga ana e Kryetarit të Trupit gjykues edhe konform nenit 383 par.2 të KPPRK-së, përkitazi me të drejtën e ankesës vetëm për sanksionin penal, por jo edhe për shkak të gjendjes faktike, si dhe
- Konform nenit 257 të KPPRK-së, aktakuza nuk ka prova të pa pranuesheme.

I akuzuari [REDAKTUAR] në shqyrtimin fillestar në fjalën e tij në kuptim të mbrojtjes ka deklaruar, pasi e ka pranuar fajësinë lidhur me veprat penale që e ngarkon prokuroria është përndryshe thellë për atë që e ka kryer por nuk ka mundur ti kontrolloj veprimet kërkon falje për këtë veprim dhe i ka propozuar gjykates që me rastin e matjes së dënimit si rrethana letësuese ti ketë theksësimet e sipër theksësuara.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit kanë egzistuar të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të cilat e përbëjnë figuren e veprës penale dhe atë: 1. "Organizimi i skemave piramidale dhe bigjosit të pa ligjshëm" nga neni 300 par.2 të KPRK-së dhe 2. "heqja apo dëmtimi i vulave ose i shenjave" nga neni 414 të KPRK-së .

*(Nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe Kryetari i trupit gjykues*

*Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasyshë të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethana lehtësuese mori se i pandehuri ka pranuar fajsinë në shqyrtimin fillestar gjyqësor, nuk ka të dhëna se me herët të ketë qenë e dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepra penale, pendesën për veprën e kryer, ka kërkuar falë për veprimet e ndërmarrura, i moshës së re i pa martuar duke qenë e bindur se në rastin konkret qëllimi i dënimit mund të arrihet, dhe një dënimi i tillë është në proporcion me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrethanave të kryerjes.

Mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale në kuptim të gjitha këtyre rrethanave duke i caktuar dënim më të butë dhe atë me zbutje të dënimit në kuptim të nenit 75 paragrafi 1 nënpar.1.3 të KPRK-së me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3/tre/ muaj të cilin dënim i pandehuri do ta mbaj pasi që aktgjykimi të merë formën e prerë, por pas shpalljes së aktgjykimit në shqyrtimin fillestar me pëlqimin e të pandehurit gjykata në kuptim të nenit 47 të KPRK-së, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3(tre) muaj, dënimin me burg i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 1.500 €, e nëse nga ana e të dënuarit nuk paguhet gjoba nga pika I. pika 1. e dispozitivit të këtij aktgjykimi, i pandehuri e vuan dënimin e shqiptuar me burg.

Nëse dënimi me gjobë në pikën II. pika 2. të dispozitivit të këtij aktgjykimi nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 par. 3 të KPRK-së, në të kundërtën do të zavendësohet në dënim burgimi, ashtu që për çdo 20 € i pandehuri do të vuaj 1 (një) ditë burg.

Konform nenit 83 të KPRK-së në dënimin e shqiptuar të pandehurit i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 17.10.2016 deri më 31.10.2016.

Bazuar në nenet 458,459 dhe 460 KPPK-së e dëmtuara ATK, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguan shumën prej 20 € në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Nga sa u theksua ma lart gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,**

**P nr.2952/2017 të dt. 07.03.2018**

**Zyrtari ligjor ,  
Gazmend Bytyqi**

**Gjyqtari,**

**Elmaz Zenuni**



**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi Gjykates së Apelit në Prishtinë, ankesa dorëzohet nëpërmes kësaj gjykate.